



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT DHE FORMITMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAMI I KUALIFIKIMIT PËR MËSIMDHËNËSIT E PRAKTIKËS
PROFESIONALE, TË EMËRUAR SI MËSIMDHËNËS ME KOHË TË PLOTË DHE
ZOTËROJNË NJË SHKOLLIM TË MESËM PROFESIONAL, PAS TË MESËM
PROFESIONAL OSE DIPLOMË TË NIVELIT BACHELOR, NË FUSHAT
PROFESIONALE PËRKATËSE**

1. Informacion i përgjithshëm

Programi i kualifikimit profesional për mësime të praktikës profesionale, të emëruar si mësime të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse (Grupi B), është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësime të kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP-së, për të plotësuar kërkesat për marrjen e tri shkallëve të kualifikimit:

- 1 – Mësues i kualifikuar
- 2 – Mësues specialist.
- 3 – Mësues mjeshtrë.

Programi është zhvilluar duke i'u përgjigjur kërkesave që Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE) ka vendosur në Udhëzimin Nr.21 dt. 27.6.2022 për mësime të kulturës profesionale me kohë të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse, që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësime të kulturës profesionale, të mëposhtme:

- Dokumente zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - zhvillimore të mësime të kulturës profesionale në AFP.
- Dokumentacioni në nivel shkolle.
- Aspekte të pedagogjisë, andragogjisë dhe të metodologjisë në mësime dhe të nxënies në arsimin dhe formimin profesional.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

2. Qëllimi i programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit të vazhduar profesional për mësime të praktikës profesionale, të emëruar si mësime të plotë dhe që zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse, është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës, bazuar në përvojën dhe praktikën e mëparshme të zbatuar për kualifikimin e vazhduar të mësuesve të AP nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe duke mbajtur parasysh përmbushjen e tre qëllimeve kryesore:

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

1. Të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë ofruesve të AFP-së, si dhe të gjithë mësimdhënësve të kulturës profesionale për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, në kuadrin e zhvillimit të vazhduar profesional.
2. Të ofrohet si një program i detyruar veçanërisht për mësuesit që atë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat e provimit të kualifikimit që bëhet për mësuesit e arsimit profesional për marrjen e shkallëve të kualifikimit
3. Të orientojë ofruesit e kurseve të akredituara të trajnimit për mësimdhënësit e AFP që të përgatisin programe në përputhje me kërkesat dhe nevojat reale për kualifikimin dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kësaj kategorie.

Programi synon rritjen e përgjegjshmërisë dhe aftësive të mësimdhënësve të kulturës profesionale për:

- ✚ njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës së AFP-së;
- ✚ rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të mësimdhënësve për një mësimdhënie të suksesshme dhe cilësore;
- ✚ domosdoshmërinë e zbatimit të koncepteve dhe ligjësive shkencore të lëndëve/moduleve në praktikë, në përputhje me specifikat e kualifikimit profesional, moshës së nxënësve dhe të kursantëve, ku japin mësim;
- ✚ njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në institucionin ofrues të AFP-së;
- ✚ zbatimin me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- ✚ realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit dhe vëzhgimit.

3. Përmbajtja e programit të kualifikimit

Programi i kualifikimit për mësimdhënësit e praktikës profesionale, të emëruar si mësimdhënës me kohë të plotë dhe zotërojnë një shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër, për të cilat kualifikohen mësimdhënësit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike me kohë të plotë në AFP që të përmbushë me sukses edhe kërkesat e provimit të kualifikimit.

Programi është ndërtuar edhe duke pasur si pikënisje standardet e mësimdhënësit të kulturës profesionale. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të kualifikimit do ta ndihmojnë mësimdhënësin e kulturës profesionale që të identifikojë nevojat e tij/saj, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

**FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE
PËR AFP-në**

Kompetenca I: “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë Ligjin për arsimin parauniversitar të ndryshuar, duke interpretuar edhe referencat për arsimin profesional; – interpretojë ligjin aktual të arsimit dhe të formimit profesional AFP; – interpretojë aktet nënligjore për arsimin dhe formimin profesional; – shpjegojë referencat që ka për mësuesit, Kodi i punës; – interpretojë referencat në Dispozitat Normative për AFP dhe profesionin e mësuesit; – dallojë elementet kyç të Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive 2020-2022 dhe të planit përkatës së veprimit; – shpjegojë veçoritë e strukturës së AFP-së; – shpjegojë strukturën institucionale dhe organizative të AFP-së; – të përshkruajë statusin e mësuesit të AP-së, funksionet dhe detyrat e tij; – shpjegojë kuptimin e parimeve, udhëzimeve, rekomandimeve dhe formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të arsimit profesional; – shpjegojë me shembuj zbatimin praktik në punën e përditshme të rekomandimeve, udhëzimeve dhe të formulimeve të tjera që barten në dokumentet bazë të arsimit dhe të formimit profesional; – shpjegojë me shembuj rastet e zbatimit të dokumenteve zyrtare në lidhje me partneritetin social në AFP. – interpretojë dhe të përdorë dokumentet administrative në shkolla profesionale; – përdorë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor, skeletkurrikulat, kurrikulat shkollore (planet, programet, ditari etj.), instrumentet e vlerësimit, 	<ul style="list-style-type: none"> – Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 15/2017, datë 16.02.2017 – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i dryshuar – Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. – Udhëzim nr 14 datë 27.05.2021”Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”. – Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore – edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. – Udhëzim Nr. 16, datë 8.5.2018 “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”. – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “per zbatimin e praktikave profesionale ne biznes ne kuadër të ndjekjes se programeve të AFP-së në institucionet publike te arsimit dhe formimit profesional”. – Udhëzimi 15 datë 26.04.2019, Për

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

evidencat (regjistrat), certifikatat etj.	<p>organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Standardet e mësimdhënësit të kulturës profesionale në AFP”. – Udhëzimi Nr. 21, datë 27.6.2022 “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP”. – Udhëzimet “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2022”.
---	---

FUSHA: ASPEKTE TË METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË PROCESIN MËSIMOR NË AFP	
Kompetenca I: “Zotërimi i njohurive didaktike dhe psiko-pedagogjike/andragogjike specifike të AFP”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë konceptet bazë të AP-së (arsim, arsim profesional, formim profesional, profesion, treg pune, kualifikim profesional, pedagogji, andragogji, psikologji, didaktikë, metodikë, përmbajtje mësimore, objektiv mësimor, metodë mësimore, stil i të nxënësve, media mësimore, vlerësimi i nxënësve, instrument vlerësimi, njohuri, shprehje, qëndrim (sjellje), kompetencë profesionale, kompetencë kyçe, të nxënësve, të nxënësve gjatë gjithë jetës, kurrikul, program mësimor, lëndë mësimore, modul mësimor, standard mësimor, kredit etj.); – japë shembuj të koncepteve dhe të termave bazë nga lënda/moduli/fusha profesionale përkatëse; – përshkruajë veçoritë e të mësuarit të njohurive; – përshkruajë veçoritë e të mësuarit të shprehive praktike; – përshkruajë mënyra të zbatimit praktik të konceptit të sipërmarrjes në lëndët apo modulet profesionale; – japë shembuj të zbatimit të partneritetit social në AP. – Për një njësi mësimore nga lënda/moduli përkatës: <ul style="list-style-type: none"> – hartojë objektivat mësimore; – përzgjedhë përmbajtjet/veprimtaritë mësimore; – përzgjedhë metodat mësimore; – përshkruajë aspekte të motivimit të nxënësve; – përcaktojë instrumentin e vlerësimit 	<ul style="list-style-type: none"> – Fjalori i arsimit dhe formimit profesional. – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12, www.akafp.gov.al – Broshura “Të mësuarit me projekte në arsimin profesional”. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Broshura “Reformimi i kurrikulës së AP-së”. – “Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP në Shqipëri”. – Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënës. – Udhëzues metodologjikë për mësimdhënien në fushën e arsimit profesional. – Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësim, përgatitjen e ditarit të mësuesit, organizimin e orës së mësim. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24 – Faqja e internetit të AKAFPK (akafp.gov.al).

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë veçoritë e stileve të të nxënit; – përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor në procesin mësimor; – analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese, objektiva mësimore, përmbajtje mësimore dhe metoda mësimore të dhëna për një njësi mësimore nga lënda ose moduli përkatës; – japë shembuj nga përvoja si mësimdhënës për motivimin e nxënësve; – japë shembuj nga përvoja si mësues, për stilet e të nxënit të nxënësve të veçantë dhe përshtatjen e mësimdhënies ndaj tyre; – – përshkruajë aspekte të menaxhimit të stresit dhe të konflikteve në mësim, si dhe të japë shembuj për to. 	
<p>Kompetenca II: “Zotërimi i parimeve bazë të të mësuarit/nxënit (referuar specifikave të AP-së)”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – rendisë parimet didaktike bazë; – shpjegojë kuptimin e secilit prej parimeve didaktike bazë; – japë shembuj të zbatimit të secilit prej parimeve didaktike bazë në procesin mësimor nga lënda/fusha profesionale përkatëse; – analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese dokumente planifikuese mësimore të dhëna, nga këndvështrimi i – përshkruajë rëndësinë e integritit të koncepteve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës, të filozofisë së të nxënit gjatë gjithë jetës, të zhvillimit të qëndrueshëm etj., në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. 	<ul style="list-style-type: none"> – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit e AKAFPK-së (akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – Faqja e internetit e AKAFPK-së (akafp.gov.al).
<p>Kompetenca III: “Përdorimi i medieve pedagogjike dhe i TIK në mësim”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “mjedisin”, “mjetet” dhe “materialet mësimore” në AFP; – klasifikojë mjetet, mjediset mësimore dhe materialet mësimore mbështetëse; – tregojë kushtet dhe kriteret për mjedisin mësimor të përshtatshëm dhe të sigurt; – shpjegojë kuptimin dhe veçoritë e përdorimit të mediave pedagogjike në AP; – listojë mediat pedagogjike; 	<ul style="list-style-type: none"> – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12. – Fjalori i arsimit dhe formimit profesional. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit e AKAFPK-së (akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<ul style="list-style-type: none"> – tregojë rëndësinë e përdorimit të TIK, mediave dixhitale dhe rrjeteve sociale në funksion të procesit mësimor. – japë shembuj të përdorimit të mediave mësimore në procesin mësimor, sipas lëndës ose modulit përkatës; – për zgjedhë mediet pedagogjike të përshtatshme për një njësi mësimore të dhënë, nga lënda/moduli përkatës; 	
Kompetenca IV: “Planifikimi i procesit mësimor në AFP”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Shpjegojë kuptimin dhe parimet ku mbështetet planifikimi i procesit mësimor; – rendisë faktorët që konsiderohen gjatë planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik); – përshkruajë veçoritë e procesit mësimor në AP; – rendisë dhe shpjegojë fazat kryesore të planifikimit të procesit mësimor (teorik ose praktik); – hartojë planin e një njësie mësimore (teorike ose praktike) sipas fazave kryesore dhe në përputhje me parimet bazë të planifikimit; – planifikojë projekte kurrikulare, ndër-lëndore dhe/ose ndërmodulare të thjeshta; – planifikojë mjetet/ mediet didaktike dhe materiale të tjera për realizimin e një njësie mësimore (teorike ose praktike); – planifikojë planin e veprimtarive që do të realizohen në biznes duke u bazuar në udhëzimet dhe dokumentet kurrikulare; 	<ul style="list-style-type: none"> – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12. – Fjalori i arsimit dhe formimit profesional. – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit e AKAFPK-së(akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, 2016 (për programin e trajnimit 30 ditor) – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24
FUSHA: VLERËSIMI I TË NXËNIT NË AFP	
Kompetenca I: “Parimet, metodat dhe instrumentet dhe llojet e vlerësimit në AFP”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin e vlerësimit të nxënësve/kursantëve; – përshkruajë llojet e vlerësimit sipas kritereve të ndryshme; – tregojë veçoritë e vlerësimit të nxënësve në AFP; – interpretojë udhëzimet për vlerësimin e nxënësve/kursantëve në AFP; – listojë format dhe metodat e vlerësimit të nxënësve/kursantëve – dallojë instrumentet kryesore për vlerësimin e 	<ul style="list-style-type: none"> – Udhëzimnr. 14, datë 27.5.202 “Për mënyrën e organizimit dheveprimtarisë së institucionevetë Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit. – Broshurat “Arsimi dhe formimi profesional”, nr. 1-12. – Fjalori i arsimit dhe formimit

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<p>njohurive dhe për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve/kursantëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> – japë shembuj të instrumenteve të vlerësimit nga lënda/moduli përkatës. – tregojë kuptimin dhe strukturën e rubrikës së vlerësimit (të njohurive, shprehive, qëndrimeve); 	<p>profesional.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Broshura “Standardet e mësimdhënies në AFP”. – Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të AFP- së në Shqipëri. – Faqja e internetit AKAFPK-së (akafp.gov.al). – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24
<p>Kompetenca II: “Vlerësimi i njohurive në AP”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të shpjegojë kuptimin, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve në AFP; – të listojë metodat dhe instrumentet kryesore për vlerësimin e njohurive dhe shprehive praktike të nxënësve/ kursantëve; – të japë shembuj të instrumenteve të vlerësimit nga lënda/ moduli përkatës – të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore (teorike ose praktike); – të shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare në AP (teorike ose praktike); – të hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të njohurive; – të hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimit të nxënësve me to; – të hartojë një test për vlerësimin përfundimtar të njohurive të nxënësve/kursantëve në lëndën profesionale përkatëse apo aspektet teorike të modulit profesional përkatës; – të ndërtojë një plan të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për një proces mësimor të dhënë (temë, kapitull, RM etj.) dhe të hartojë instrumentet përkatëse të vlerësimit; – të japë shembuj të llogaritjeve të mesatare të ponderuara duke konsideruar vlerat e krediteve dhe koeficienteve të tjerë. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24 – Udhëzues për vlerësimin e nxënësve në AFP. – Udhëzim nr 14 datë 27.05.2021 ”Për vlerësimin e nxënësve në AFP” – Udhëzues praktik për hartuesit e testeve me zgjedhje të shumëfishtë
<p>Kompetenca III: “Vlerësimi i shprehisë praktike në AFP”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për situata të ndryshme mësimore të shprehisë praktike; – shpjegojë mënyrat e organizimit të provimeve përfundimtare në AFP të shprehisë praktike; – hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të shprehisë praktike; – hartojë lloje të ndryshme instrumentesh për vlerësimin e nxënësve për nivele të ndryshme të shprehisë praktike ose moduli përkatës; – hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimit të nxënësve me to; – hartojë një listë kontrolli/ udhëzues përmbushjeje për vlerësimin përfundimtar shprehisë praktike të nxënësve të modulit përkatës profesional; – analizojë në mënyrë kritike dhe krijuese një instrument kompleks (rubrikë) vlerësimi të dhënë; – analizojë rezultatet e vlerësimit të një grupi nxënësish për një shprehje praktike dhe të nxjerrë konkluzionet e duhura; – japë shembuj të llogaritjeve të mesatare të ponderuara duke konsideruar vlerat e krediteve dhe koeficienteve të tjerë; – interpretojë referencat për vlerësimin e nxënësve në biznes sipas rregullores për zbatimin e praktikave në biznes. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24 – Urdhër nr 220, datë 16.09.2020 për miratimin e rregullores “për zbatimin e praktikave profesionale në biznes në kuadër të ndjekjes së programeve të AFP-së në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional”. –
<p>Kompetenca IV: “Vlerësimi i qëndrimeve dhe vlerave në AFP”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – përzgjedhë metodat dhe instrumentet e duhura të vlerësimit për qëndrime dhe vlera; – hartojë instrumente të thjeshta të vlerësimit të nxënësve/kursantëve për nivele të ndryshme të qëndrimeve dhe vlerave; – hartojë instrumente komplekse (rubrika) për vlerësimin e qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve dhe të llogarisë rezultatin e vlerësimit; – hartojë njësi testi për vlerësimin përfundimtar të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve/ kursantëve në lëndën profesionale përkatëse apo modulit profesional përkatës. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24 – Udhëzues metodologjik për hartimin e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale”

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

FUSHA: KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR	
Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësimit”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimitdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – njohë rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhenrespektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; – të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. – përshkruajë veçoritë e perceptimit pamor dhe dëgjimor në procesin mësimor; – njohë teknika të kapërcimit të barrierave të komunikimit në procesin mësimor teorik dhe praktik; – dallojë standardet bazë të mësuesit në lidhje me komunikimin në procesin mësimor në AFP; – të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij, brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> – Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.
Kompetenca II: “Zhvillimi i aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësimitdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “aftësitë kyçe” në AFP; argumentojë rëndësinë e integritetit të aftësive kyçe në përmbajtjet mësimore dhe në procesin mësimor në AFP; – jetë fleksibël në zgjedhjen e strategjive mësimitdhënëse që nxisin novatorizimin dhe dijet personale; – zbatojë strategji për manaxhimin e kohës që krijojnë mundësi për zhvillimin e karrierës në vendin e punës; – jetë i hapur dhe aktiv, për t’i përdorur kolegët dhe profesionistët e tjerë si burim për të mësuar dhe si burim frymëzimi; – jetë kontribues në gjithë proceset e zhvillimit dhe të nxënësve të komunitetit të shkollës; 	<ul style="list-style-type: none"> – Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional. 2020-2022 – Komisioni Evropian, DG – Arsimi dhe Kultura (2011) – Grupi tematik i punës “zhvillimi profesional i mësuesve”: Raporti I aktivitetit : Politikat për përkufizimin dhe përshkrimin e kompetencave të mësuesve. https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/mesimdhenea-me-baze-kompetence – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të zhvillimit i aftësive kyçe të nxënësve të rinj dhe të rritur.

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<ul style="list-style-type: none"> – punojë për zhvillimin profesional të tij për të rritur efikasitetin në mësimdhënie, si edhe ekspertizën në lëndën/modulin që zhvillon; – përdorë instrumente dhe metoda mësimore për përmbushjen e objektivave në fushën e të nxënësve social dhe emocional; – zhvillojë kompetenca kyçe - me një theks të veçantë tek aftësitë e shkrimit dhe leximit, aftësitë numerike dhe dixhitale. 	
<p>Kompetenca III: “Zbatimi i parimeve të barazisë, gjithëpërfshirës dhe diversitetit në procesin mësimor”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “barazinë” dhe “shancet e barabarta”, “gjithëpërfshirjen”, “personat me nevoja të veçanta” dhe “diversitetin” në AFP; – japë shembuj të zbatimit të parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor në AFP. – krijojë i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës gjatë orës së mësimi; – përfshijë të gjithë nxënësit në projekte dhe ngjarje sociale; – aktivizojë nxënësit në përmirësimin e përfshirjes sociale; – njohë diversitetin brenda dhe përtej grupeve etnike; – zbatojë parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor; – ofrojë metodologji dhe burimeve në procesin mësimor bazuar në parimet e barazisë, gjithëpërfshirës dhe diversitetit. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Nxitja e kulturës demokratike dhe diversitetit në shkolla, – Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Profesional. 2020-2022. – Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. – Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. – Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor.
<p>FUSHA: MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP</p>	
<p>Kompetenca I: “Përgatitja dhe mirëmbajtja e mjedisit dhe mjeteve për mësimin digjital në AFP”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “mjedisin digjital”, “mjetet digjitale”, dhe mësimin digjital”; – tregojë veçoritë e përgatitjes dhe përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në AFP; – japë shembuj të përdorimit të mjedisit dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor, për një njësi mësimore nga lënda/ moduli përkatës; 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mjedisit dhe mësimin digjital. – UDHËZUES i përditësuar për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga tiranë, më 30 .03.2020 përhapja e COVID19.

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<ul style="list-style-type: none"> – menaxhojë dhe mirëmbajë mjedisin dhe mjetet digjitale; 	<ul style="list-style-type: none"> – UDHËZUES për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional Tiranë, 23.03.2020 – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24
<p>Kompetenca II: “Përgatitja e materialeve didaktike digjitale për mësimin digjital në AFP”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “materialet didaktike digjitale”; – tregojë lloje dhe formate të materialeve mësimore dixhitale në mësimin teorik dhe praktik; – tregojë rëndësinë e përgatitjes dhe së materialeve mësimore dixhitale në funksion të procesit mësimor në AFP. – përdorë teknika të përgatitjes dhe përdorimit të materialeve mësimore dixhitale në mësimin teorik dhe praktik; – japë shembuj të përdorimit të materialeve mësimore dixhitale në mësimin teorik dhe praktik; – përzgjedhë burimet e duhura për marrje informacioni për përgatitjen e materialeve mësimore; 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mësimin digjital. – UDHËZUES i përditësuar për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga tiranë, më 30 .03.2020 përhapja e COVID19. UDHËZUES për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional Tiranë, 23.03.2020. – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24
<p>Kompetenca III: “Përgatitja e instrumenteve dhe kryerja e vlerësimit dixhital të nxënësve dhe kursantëve”.</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë kuptimin për “vlerësimin digjital”; – përdorë platforma të tilla si <i>MS Teams</i>, <i>Moodle</i>, <i>OpenEdx</i>, <i>Google form</i> etj., për të zhvilluar teste dixhitale; – dallojë veçoritë e testeve në mjedis Interneti dhe testeve në mjedis të mbyllur (<i>Local Area Network - LAN</i>); – tregojë lloje ndryshme të njësive (pyetjeve) të testeve dixhitale; – japë shembuj në lidhje me llojet, formatet e instrumenteve të vlerësimit dixhitale dhe teknikave të përgatitjes dhe përdorimit të instrumenteve të vlerësimit dixhitale; 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të mjedisit dhe mësimin digjital. – UDHËZUES i përditësuar për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga tiranë, më 30 .03.2020 përhapja e COVID19. – UDHËZUES për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional Tiranë, 23.03.2020. – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<ul style="list-style-type: none"> – analizojë veçoritë e zhvillimit të formatit të kombinuar (<i>blended</i>) ose online – të sinkronizuar. 	dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24
<p>Kompetenca IV: “Realizimi i mësimit online dhe të kombinuar (<i>blended</i>) dhe përdorimi i komuniteteve të praktikës online”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – dallojë formatet dhe veçoritë e mësimit online dhe të kombinuar dhe mënyra të zbatimit të tyre; – njohë teknika të planifikimit dhe praktikimit të formateve të ndryshme të mësimit online dhe të kombinuar; – japë shembuj të përgatitjes dhe zhvillimit të mësimit online dhe të kombinuar, për një njësi mësimore nga lënda/ moduli përkatës; – përdorë Internetin dhe komunitetet e praktikës për zhvillimin e vazhduar profesional dhe shkëmbimin e përvojës së mësimdhënësve; – tregojë rëndësinë e përdorimit të mediave dixhitale dhe rrjeteve sociale në funksion të procesit mësimor në AFP. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – UDHËZUES i përditësuar për mësimin në kushtet e shtëpisë, për shkak të situatës së krijuar nga tiranë, më 30 .03.2020 përhapja e COVID19 – UDHËZUES për mësimin dhe vlerësimin në kushtet e shtëpisë, për lëndët profesionale dhe modulet profesionale në Arsimin Profesional Tiranë, 23.03.2020 – AKAFPK – Udhëzues për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale 2023-24 – Manuali për edukimin e qytetarisë digjitale i Këshillit të Evropës
FUSHA: ZHVILLIMI PROFESIONAL NË PROFESIONIN PËRKATËS	
<p>Kompetenca I: “Kompetenca intelektuale dhe pedagogjike”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – zbatojë njohuritë ekzistuese; – vendosë marrëdhënie pedagogjike të përshtatshme në përvetësimin dhe transformimin e njohurive; – analizojë, sintetizojë, krahasojë dhe manifestojë cilësitë inteligjencës dhe të të menduarit kritik; – të hartojë standarde lëndore; – përcaktojë kritere për arritjen e standardeve lëndore. 	<ul style="list-style-type: none"> – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar. – Standardet e mësimdhënësit të kulturës së përgjithshme në AFP. – Broshure Informative nr 5 i AKAFP. – Arsimi dhe Formimi Profesional nr 14.
<p>Kompetenca II: “Kompetenca operative”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – përshkruajë veprimtaritë që përfshijnë kualifikimin profesional të nxënësit/ kursantit sipas profilit të përzgjedhur, referuar listës kombëtare të kualifikimeve në AFP; – japë shembuj të orientimit profesional të 	<ul style="list-style-type: none"> – Lista kombëtare e kualifikimeve në AFP. – Manuali “Bazat e didaktikës në AFP”, i rishikuar – Arsimi dhe Formimi Profesionale, nr 13 https://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-kualifikimeve/

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

<p>nxënësit për karrierën, mbështetur në drejtimin dhe profilin përkatës;</p> <ul style="list-style-type: none"> – marrë pjesë aktive në përditësimin e të rejave në profesion; – zbatojë metodologji organizative të improvizimit pedagogjik. 	
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
<p>Kompetenca I: “Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësimdhënësi i kulturës profesionale teorike dhe/ose praktike në AFP duhet të jetë i aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; – demonstrojë zbatimin e rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor; 	<ul style="list-style-type: none"> – Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të Gjuhës shqipe. – Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. – Fjalor për Arsimin dhe Formimin Profesional, (Pajtim Bejtja, Maksim Konini, Alqi Mustafaj).

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MFE që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.